

V E N D I M

Nr.415, datë 7.8.1995

PER NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.360, DATE 10.7.1995 "PER REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA DHE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE"

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit e
Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë
10.7.1995, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, prapa fjalëve: "Lëndë druri e sharruar dhe
binarë" të shtohen fjalët: "Me përjashtim të elementeve
(detaleve) të drurit.

2. Shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:
"Ngarkohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe e
Tregtisë për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij
vendimi".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
Aleksandër Meksi